

VENDIM
Nr. 78, datë 7.10.2015

**PËR MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E
MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE
VENDEVE TË RAJONIT ME AUTORITETIN BANKAR EVROPIAN**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, shkronja “a” dhe paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 29 të Kodit të Procedurave Administrative, bazuar në propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë zëvendësguvernatorin e dytë, zonjën Natasha Ahmetaj, për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë dhe vendeve të rajonit me Autoritetin Bankar Evropian (European Banking Authority-EBA).

2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni